

## **Mundësi për aplikim në thirrjen “A European Collaborative Cloud for Cultural Heritage – Innovative tools for documenting, interlinking and organising data HORIZON-CL2-2024-HERITAGE-ECCCH-01-02” nën Programin Horizon Europe**

### **Synimi i Thirrjes:**

Kjo thirrje synon zhvillimin e mjeteve dhe metodave inovative në kuadër të të “Reve Bashkëpunuese Europiane për Trashëgiminë Kulturore” (European Collaborative Cloud for Cultural Heritage) (ECCCH), me fokus në dokumentimin, ndërthurjen dhe organizimin e të dhënave për trashëgiminë kulturore.

### **Objektivat kryesore përfshijnë:**

- Krijimi dhe përmirësimi i bibliografive të shënuara.  
Ofrimi i mjeteve që automatizojnë krijimin e bibliografive dhe mbështesin punën bashkëpunuese për të rritur efikasitetin.
- Dokumentimi i rezultateve të punës në terren.  
Zhvillimi i mjeteve për ruajtjen dhe analizimin e të dhënave nga gërmimet arkeologjike, eksplorimet paleontologjike dhe procese të tjera të mbledhjes së të dhënave.

### **Rezultatet e Pritshme:**

- Përdorim i gjerë i ECCCH nga profesionistët dhe studiuesit evropianë të trashëgimisë kulturore për krijimin dhe organizimin e të dhënave digjitale.
- Sigurimi i informacionit të qartë dhe moduleve të trajnimit për mjetet dhe metodat e reja të zhvilluara.

### **Karakteristikat Kryesore:**

- Zhvillimi i mjeteve të bazuara në teknologji AI për të analizuar dhe integruar të dhënat e trashëgimisë kulturore.
- Ndërthurja e bazave të të dhënave të institucioneve të ndryshme për të rritur ndërveprueshmërinë.
- Sigurimi i mjeteve vizuale për analizën dhe prezantimin e të dhënave, përfshirë shfletues të avancuar 3D.

### **Kriteret e Konsorciumit:**

Të përfshihen të paktën **3 entitete** ligjore të pavarura nga vende të ndryshme të BE-së ose vende të asociuara, të paktën **1 nga Vendet Anëtare** dhe **2 nga Vendet Anëtare dhe Vendet e asociuara**.

### **Buxheti:**

Buxheti total për këtë thirrje është **8 milionë euro** dhe thirrja do të financojë **2 projekte** me grante që variojnë nga **3 deri në 4 milionë euro për projekt**.

### **Mënyra e Aplikimit:**

Aplikimi kryhet përmes portalit të BE-së për Financime dhe Tendera dhe afati i fundit për dorëzimin e projekt-propozimeve është më datë **22 Janar 2025, ora 17:00 (ora e Brukselit)**

### **Link i Thirrjes:**

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/HORIZON-CL2-2024-HERITAGE-ECCCH-01-02?isExactMatch=true&status=31094501,31094502&frameworkProgramme=43108390&callIdentifier=HORIZON-CL2-2024-HERITAGE-ECCCH-01&order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate>